



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:918408

Datë: 26.12.2024

Numri i dokumentit: 06656606

C.nr.2022:105143

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.A nga Ferizaj, rr., me numër personal, të cilin e përfaqëson av. Fitim Shabani nga Ferizaj, kundër të paditurës Kompania Kosovare për Distribuum dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS), me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Trëndelina Kryeziu nga Ferizaj, me objekt të kontestit kompensim dëmi, vlera e kontestit 8042,57€, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, kurse me datë 26.12.2024, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit A.A nga Ferizaj kundër të paditurës KEDS, me seli në Prishtinë.
- II. DETYROHET e paditura KEDS, me seli në Prishtinë, që sipas përgjegjësisë në shkallën prej 30% të paditurës dhe 70% të paditësit A.A, të ja kompensojë paditësit dëmin material në shumën e përgjithshme prej 2412.77€ (dymijë e katërqind e dymbëdhjetë euro e shtatëdhjetë e shtatë cent), të shkaktuar më datë 28.05.2013, rreth orës 22:25 në Ferizaj, rr. në punëtorinë e paditësit, i cili kishte ardhur si pasojë e çrregullimit të energjisë elektrike, së bashku me normën e kamatës në lartësi prej 8% në vit, e cila do të llogaritet nga data e ushtrimit të padisë, datë 12.03.2014, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.
- III. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit A.A nga Ferizaj kundër të paditurës KEDS, me seli në Prishtinë, përtej shumës së gjykuar si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e deri në shumën prej 8042,57€, përkatësisht diferenca prej 5,629.80€ (pesëmijë e gjashtëqind e njëzetë e nëntë euro e tetëdhjetë cent)

IV. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesa e paditësit A.A lidhur me kompensimin e shpenzimeve procedurale dhe DETYROHET e paditura KEDS, me seli në Prishtinë, që sipas përgjegjësisë në shkallën prej 30%, të ja kompensojë paditësit shumën prej 382.56€, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm, ndërsa REFUZOHET PJESËRISHT SI E PABAZUAR diferenca e kërkuar në lartësinë prej 892.64€.

A r s y e t i m

Rrjedha e çështjes

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin C.nr.178/14 të dt. 14.11.2017, ka vendosur: “I. Refuzohet në tërësi si të pabazuar kërkesëpadia e paditësit A.A nga Ferizaj ushtruar kundër të paditurës KEDS, për shkak të kompensimit të dëmit në vlerën prej 20,000€, në emër të çrregullimeve elektrike. II. Secila palë i bartë shpenzimet e procedurës.”

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë me aktvendimin Ac.nr....., të datës ..., ka vendosur: “aprovohet e themeltë ankesa e paditësit A.A nga Ferizaj, prishet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr..... të dt. ... dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim.”

Kjo lënd me vendimin e Kryetarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj me numër të dokumentit të dt. ... është ricaktuar nga gjyqtari B.E te gjyqtari Armend Ahmeti, konform planit të rishpërndarjes së lëndëve të dt. ..., me numër GJA.nr....., të miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës më dt. ..., me nr. KGJK.nr.....

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi A.A përmes të autorizuarit të tij me datë 12.03.2014 ka parashtruar padi pranë kësaj gjykate kundër të paditurës me objekt kontesti shpagim dëmi. I autorizuari i paditësit av. Fitim Shabani në riprocedurë, gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë. Nga provat e nxjerrura gjatë kësaj procedure kontestimore është vërtetuar se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e bazuar. Nga provat e administruara gjatë kësaj procedure kontestimore është vërtetuar kërkesëpadia e paditësit si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia e saj, është bërë e bazuar nga provat e nxjerrura gjatë kësaj procedure me theks të veçantë nga ekspertizat e realizuara, e që nga të gjitha këto pamëdyshje është konstatuar se përgjegjësia për ndodhjen e kësaj ngjarje është e të paditurës e që rrjedhimisht nisur nga

dispozitat e LMD-së ekziston përgjegjësia e të paditurës që këtë dëm të e kompensoj, e që kjo duke qenë se për shkak të çrregullimeve të energjisë elektrike ditën kritike përkatësisht për shkak të luhatjes tensionit ka pasur djegie puntoria e paditësit, respektivisht mobileria e tij ne rr. “” në Ferizaj, rreth orës 22:25 e cila ka qenë punëtori familjare me pak mjete që e akceptojnë dhe e përballojnë lidhjen energjetike që ka ekzistuar e kjo e konstatuar edhe nga eksperti i elektros, ku gjatë kësaj procedure kontestimore dhe provat e administruara është vërtetuar se deri tek djegia ka ardhur nga tensioni i energjisë ku pajisja e KEDS-it AMR-ja e cila e regjistron vazhdimisht rrymën dhe energjinë elektrike nga trafo, në qoftë se ka ndonjë rrjedhje të madhe të energjisë dikund menjëherë në lakore vërehet ndryshimi përkatësisht kërcimi i lakores e ajo ka ndodhur me datë 28.05.2013, dhe jo nga kabllot e lidhura pas njesorit elektrik siç pretendon e paditura pasi që në ditën kritike për shkak të luhajtjes së tensionit të energjisë elektrike rreth 10-15 shtëpi kanë qenë të afektuara, dhe ku secila prej tyre ka pësuar nga një dëm në pajisjet e tyre shtëpiake ku me aktvendim është refuzuar propozimi për dëgjimin e këtyre dëshmitarëve. Sipas ekspertizës së elektroteknikës është vërtetuar edhe gjendja faktike në të cilën është konstatuar se për ramje të tensionit përgjegjësia është e KEDS-it që sipas ligjit dhe normave teknike tensioni 220v/380 (+5% dhe -5%) nuk guxon të ketë luhatje më të mëdha në rrjet e që ato vlera te matjeve në atë kohë po të i kishte paraqitur KEDS-i përmes raportit të komisionit të ekspertizës por nuk i ka në raport teknik që i ka kryer komisioni teknik i KEDS –it e që janë relevante për cfarëdo ekspertize, ku kjo ekspertizë është kryer me komoditet të mjaftueshëm si në kohën me 27.06.2013 ndërsa ngjarja ka ndodhur me datë 28.05.2013 dhe me kuadër dhe pajisje të mjaftueshme e jo nën presionin e urgjencës që është e çuditshme pse nuk janë matur tensionet fazore në hymje të njehsorit që është baza e argumentit, se cilësia e energjisë është sipas ligjit që përcaktojnë edhe normat teknike që edhe sot shërbehen po me ato norma. Ku e paditura nuk ka bërë matje të tensionit në vend ngjarjes tek ora në vitin 2013 edhe pse i ka pasur mundësit teknike, KEDS nuk ka bërë matjet dhe fotografit sepse kjo nuk i ka konvnuar meqënëse tensioni ka qenë i ulët.Sa i përket pretendimit se lidhja e energjisë elektrike ka qenë në mënyrë jo të duhur me pretendimin se energjia elektrike ka qenë e destinuar për konsum familjar, ndërsa paditësin e ka përdorur për qëllim afarist dhe se numri tarifor është i ndryshëm, ngase çmimi i tarifës për biznese është më i lartë se ai për amvisëri. Një rrethanë e tillë nuk është bazë që e liron të paditurën nga përgjegjësia e kompensimit, kjo për faktin se në vetë pyetjen e përfaqësuesit të paditësit se a ndryshon vetëm numri tarifor që ka të bëjë me çmimin e energjisë elektrike, apo ndryshon edhe lloji i energjisë apo lartësia e kilovatëve, e paditura është deklaruar se kemi të bëjmë vetëm me ndryshim tarifor e që nënkupton vetëm në çmim të energjisë, mirëpo nuk ndryshon në sasinë e energjisë së përçuar, e që një rrethanë e tillë do te mund të ishte bazë që paditësi të sanksionohej nga e

paditura për ndryshim tarifor mirëpo asesi nuk mund të përdoret si bazë që e paditura të lirohet detyrimi i kompensimit të këtij dëmi. Andaj gjykatës i propozojmë që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj në tërësi si të bazuar duke pasur parasysh rrethanat e lartëcekura.

I ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

E paditura përmes të autorizuarit të saj në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesën e paditësit si të pa bazuar. E autorizuarja e të paditurës Trëndelina Kryeziu nga Ferizaj në riprocedurë, gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë përgjigjes në padi si dhe deklarimeve tona, pasi që paditësi gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor në asnjë rast dhe asnjë provë të vetme nuk ka mundur t'i provojë gjykatës se pretendimet e përshkruara në padi kanë bazë dhe se e paditura i ka shkaktuar paditësit dëmin për të cilën kërkon kompensim. Fillimisht njoftojmë gjykatën se paditësi nuk ka mundur të argumentojë ekzistimin e legjitimitetit real aktiv që të figurojë si palë paditëse në këtë procedurë, ndaj edhe bazuar në aktvendimin e Gjykatës së Apelit lidhur me këtë çështje me të cilin është udhëzuar Gjykata e shkallës së parë që në rast të ekzistimit të dilemës së kësaj rrethane, të kërkohej prova nga paditësi, dhe kjo tanimë është vërtetuar disa herë si nga mungesa e provave, ashtu edhe nga deklarimi i vetë paditësit gjatë dëgjimit të tij në cilësinë e palës ku ka thënë se nuk posedonte pronësinë mbi objektin në të cilin është shkaktuar zjarri dhe nuk i posedonte këto prova, edhe pse paditësi vetë në padinë e tij thirret në atë se: “më datë 28.05.2013 i është djegur punëtorja e tij në të cilën ai zhvillonte aktivitetin e tij biznesor, si pasojë e çrregullimeve të energjisë elektrike”, ky fakti i rëndësishëm sa i përket vendosjes lidhur me hüdhen poshtë të padisë si të palejuar. Se kjo padi ishte e ndërtuar mbi pretendime të paqena kjo dëshmohej edhe nga fakti se paditësi kërkon përgjegjësi nga e paditura lidhur me dëmin që i është shkaktuar nga vetë veprimet e tija të palejuara lidhur me kyçjen në energji elektrike, fakt ky mjaftueshëm i provuar nga prova të shumta, pasi që paditësi ka keq-shfrytëzuar energjinë elektrike nga instalimi i shtëpisë dhe ka bërë shkelje të rregullave teknike dhe kushteve teknike të kyçjes, sepse sikurse të mos kishte lidhur në atë mënyrë energjinë elektrike në atë objekt, dhe do të pajisej me të në mënyrë të rregullt, do të kishte Marrëveshje për Furnizim me Energji Elektrike me KESCO-n, dokument të cilin nuk e posedonte, ndërsa vazhdonte të thirrej në atë se ishte i lidhur në mënyrë të rregullt sepse sipas tij furnizimi nga shtëpia e tij në objekt ishte, përbënte një formë të rregullt të furnizimit, dhe nuk kishte pse të lidhte marrëveshje me KESCO-n, ndaj konsiderojmë se tanimë për gjykatën është fakt notor që paditësi ka qenë vetëm konsumator shtëpiak (grupi tarifor 4/02), dhe ka bërë lidhje jo të rregullt në objekt, çka nënkupton gjithashtu se i njëjti nuk e ka njoftuar

të paditurën lidhur me destinimin e drejtë të furnizimit të tij me energji elektrike, dhe me qëllim, me vetëdije ka shkelur kushtet/rregullat e furnizimit, kështu duke keq-shfrytëzuar edhe kostot e pagesës së energjisë për grupin tarifor siç ka dashur t'a shfrytëzojë energjinë, shkelje kjo e cila evidentohet edhe sipas Rregullave të furnizimit dhe sistemit tarifor të aprovuar nga ZRRE, dhe qëllimisht ka zgjedhur kundërligjshëm të shfrytëzojë energjinë apo grupin tarifor të saj, jo në përputhje me rregullat. Paditësi duhej obligativisht të kërkonte pëlqim elektro-energetik për furnizimin me energji elektrike me detajet e pajisjeve që do të shfrytëzoheshin, duke kompensuar edhe taksat mbi fuqinë e njëkohshme të aktivizuar dhe duke i përcaktuar pikën kyçëse (linjat, kabllot etj) adekuate kërkesave të tij dhe që mundësojnë furnizimin normal pa pengesa, dhe është evidente që investimet nga pika kyçëse në rrjet deri në vendin e shpenzimit duhet ti kryejë vetë konsumatori, gjë që i njëjti iu ka bishtëruar këtyre obligimeve, kështu duke ngritur kapacitete pa lejen dhe aprovimin e KEDS – rrethana këto të cilat konsiderojmë bindshëm se duhet të merren parasysh gjatë vendosjes lidhur me hudhjen poshtë ose refuzimin e kësaj padie, edhe sikurse të ishte vërtetuar baza juridike dhe lartësia e kësaj padie. Nga këto arsye i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë si të pabazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Vlerësimi i provave

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike, në shqyrtimin kryesor-publik të mbajtur në rigjykim me datë 06.11.2024, gjykata bëri administrimin e provave sikurse janë:

Nga vërtetimi i datës i lëshuar nga Shërbimi i Zjarrfikjes dhe Shpëtimit në Ferizaj me nr. të lëndës ..., gjykata ka vërtetuar se më dt. 28.05.2013 rreth orës 22:05 min Shërbimi i Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, lajmin e pranoi nga Policia e cila informoi shërbimin tonë se në rr. Enver Topalli ka ndodhur një rast zjarri në një punëtori mobilerie. Pas marrjes së informatave ekipa zjarrfikëse arriti në vendin e ngjarjes dhe vëren se kishte zjarr në punëtorinë e lartcekur ku shërbimi zjarrfikës fillon intervenimin në shuarjen e zjarrit njëherit mobilizohet me automjete shtesë zjarrfikëse deri në lokalizimin e plotë. Dëmet materiale janë: nga zjarri i përfshirë janë djegur: mobileria tërësisht si dhe maqinat e punës të dëmtuara.

Nga vërtetimi i datës ... i lëshuar nga Stacioni Policor në Ferizaj-Njësia e Hetimeve, me nr. HET / VER / ..., gjykata ka vërtetuar se me dt. ... në Stacionin Policor në Ferizaj është raportuar një

lart incident zjarri ku i lartpërmenduri D.I.A raporton se zjarri kishte përfshirë një objekt përcjellës ish depo mobilieri ku si pasojë e këtij zjarri i është djegur depoja tërësisht.

Nga raport i Komisionit të formuar në bazë të vendimit nr. ... të dt. ... të KEDS-it Distrikti Ferizaj, divizioni i rrjetit, gjykata ka vërtetuar se komisioni ka dalur më dt. ... në vendin e ngjarjes dhe ka konstatuar se objekti i depos dhe makinave është afër shtëpisë së banimit (në oborr), furnizimi me energji elektrike është bërë nga shëtpia me një kabëll vazhduese. Sipas kësaj që pamë në vendin e ngjarjes kjo mënyrë e furnizimit me kabëll është jo e pranueshme dhe nuk i plotëson normat teknike të instalimit teknik të objektit. Është dashtë kabëlli të jetë i vendosur në gypa adekuat të jetë i mbrojtur nga dëmtimet fizike, kushtet e tjera. Kjo djegie e depos dhe makinave ka ndodhë brenda instalimit të objektit pra deri te shtylla ka përgjegjësi KEDS-i ndërsa kjo ne mendojmë se është shkaktar i instalimit të brendshëm jo adekuat.

Me leximin e kërkesës të drejtuar nga A.A të paditurës më dt. .. vërtetohet se konsumatori ka paraqitur kërkesë a) pëlqim elektroenergetik për objektin e djegur në deponë si pasojë e rrymës, dhe ka kërkuar dislokim dhe vazhdim rrjeti 3. Rrjeti të tensionit të ulët

Me shikimin në 11 foto të bashkangjitura padisë gjykata ka vërtetuar se shihet një objekt i djegur me pjesë të caktuara të punëtorisë, shihet ora e energjisë elektrike, kabloja e të ngjajshme.

Gjykata duke vepruar konform nenit 199 të LPK në kuptim të vërejtjeve dhe sugjerimeve të Gjykatës së Apelit e Kosovës të dhëna në aktvendimin Ac.nr.... të datës ..., të cilat janë të obligueshme për këtë gjykatë, ka aprovuar propozimin e paditësit përmes të autorizuarit të tij që në këtë shqyrtim gjyqësor të nxirret ekspertiza e elektros. Kjo për faktin që gjyqtari i kaluar i ngarkuar me këtë çështje me aktvendimin e dt. ... ka caktuar Fakultetin Teknik të Universitetit të Prishtinës, i cili ka obligim që të angazhoj një ekspert nga fusha e elektroteknikës për të konstatuar se cili ka qenë shkaktari i zjarrit të dt. 28.05.2013, në ora 25:05 min., për të cilin paditësi thekson se i është shkaktuar dëm. Mirëpo gjyqtari aktual tani i angazhuar me këtë çështje duke qenë se në bazë të fletëkthesës së dt. ... FIEK refuzon dërgesën, ka vendosur që ekspertiza të bëhet nga eksperti i elektros i licencuar nga KGJK dhe me këtë rast ka caktuar në bazë të radhës ekspertin I.C nga Ferizaj, për ta punuar ekspertizën në këtë çështje, kurse nuk e ka marrë për bazë propozimin e paditësit për emrin e ekspertit, që si ekspert gjyqësor të caktohet Y.Z meqë e paditura kishte shprehur kundërshtime në emrin e ekspertit.

Me leximin e Ekspertizës së elektros e dt. e ekspertit I.C nga Ferizaj, gjykata ka vërtetuar se: Rasti i parë (më i zakonshëm), në rastin konkret zjarri shkaktohet nga instalimi jo adekuat

(profesional) i kabllit të furnizimit. Shumicën e rasteve seksioni më i vogël i kabllit në krahasim me ngarkesën e pajisjeve elektrike shkakton nxemje të kabllit dhe si pasojë e nxemjes së kabllit vie deri te lidhja e shkurtër dhe shkaktohet zjarri e që në orën 22:05 min të dt. ... ka ndodhur havaria që përputhet me raportin e qendrës së KEDS-t=it AMR më ... ora 22:30 deri 22:45 ku deri sa e kanë lokalizu furnizimin e mobilerisë me energji elektrike e tërë lagjja ka qenë pa energji elektrike. Rasti i dytë (i rrallë por i mundshëm) Mundësia tjetër e shkaktimit të zjarrit është që duke u bazuar në deklaratat e të dëmtuarit që ka pasë luhatje në rrjetë dhe si pasojë ka qenë aksidenti ajo nuk mund të qëndroj pasi që kjo punëtori është e furnizuar nga e njëjta orë elektrike dhe nuk ka as një dëshmi (provë materiale që në shtëpinë e tij apo kojshitë e tij ka pas mbitension në rrjetë që ndodhë në shumë raste këputje të përquesit të neutrit (zeros) por në këtë rast eksplodojnë pothuajse të gjitha poqat elektrike që janë aktive në atë kohë në tërë lagjen që janë të kyqur në atë linjë (dalje) të trafos. Rasti i tretë (të veçanta) Nëse tensioni ka qenë i ulët dhe shpenzuesit i ka furnizuar me tension 380v (përgjegjësi e mjeshtrit që ka instalue) ditën kur ka qenë tensioni i dobët dhe në orët e vonshme kur bie ngarkesa në lagjen konkretisht në orën 22:05 min është ngrit tensioni dhe si pasoj ka shpërthyer izolimi i pajisjeve 220v-she dhe ka shkaktuar zjarrin. PJESA E DYTË E RAPORTIT (përgjegjësit e aksidentit) Për instalimin jo adekuat (jo profesional) të punëtorisë familjare përgjegjës teknik është A.A gjegjësisht (mjeshtri) që në deklaratë thotë se ka harruar cilin e ka pasë mjeshtrë. Kurse për ramje të tensionit që në atë kohë MAJ 2013 por edhe sot përgjegjës është KEDS-i që sipas ligjit dhe sipas normave teknike tensioni 220v/380 (+5% ose -5%) nuk guxon të ketë luhatje më të mëdha në rrjetë e që ato vlera të matjeve në atë kohë po të ishin i kishte paraqit KEDS-i përmes raportit të komisionit të ekspertizës së tyre apo avokati i tyre z. Skender Musa por nuk i ka në raportin teknik që i ka kryer komisioni TEKNIK i KEDS-it e që janë relevante për çfarëdo ekspertize. Kjo ekspertizë është kryer me komoditet të mjaftueshëm si në kohën më 27.06.2013 dhe me kuadër dhe pajisje të mjaftueshme e jo nën presionin e urgjencës që është e çuditshme pse nuk janë matë tensionet fazore në hymje të njehsorit që është baza e argumentit se cilësia e energjisë është sipas ligjit që e përcaktojnë edhe normat teknike që edhe sot shërbehen po me ato norma.

KONSTATIM Shpërthimi i zjarrit ka ndodhë për shkak të prishjes së izolimit të kabllit ose të pajisjeve qoftë nga mbirryma shkaktarë seksioni i vogël i kabllit, qoftë mbitensioni që paraqitet si pasojë e humbjes (këputjes) së përquesit të zeros ose qëllimshum i kyqur në mes dy fazave por pa mbrojtje nga mbitensioni gjë që është përgjegjësi e instaluesit por kjo bëhet vetëm kur tensioni është i dobët e që rrjedhimisht përgjegjës do të ishte edhe KEDS-i. Andaj si përfundim unë si ekspert i elektros vlerësoj se shkaktori dhe përgjegjës kryesor teknik është instaluesi i

rrymës në atë punëtori, por këto gabime që i ka bërë mjeshtri janë si pasojë e tensionit të ulët elektrik e që për këtë duhet të marrë një pjesë të përgjegjësisë teknike edhe KEDS-i.

Në sqarimet shtesë të dhëna në shqyrtimin gjyqësor, eksperti gjyqësor i elektros ka deklaruar se: “Mbetem në tërësi pranë konstatimit të përshkruar në faqen e fundit të ekspertizës, sikur të ishte në shkresat e lëndës një ankese nga ana e paditësit lidhur me tensionin e dobët të energjisë elektrike, atëherë përgjigja do të ishte se përgjegjësia do të ishte e ndare 50/50 ndërmjet KEDS-it dhe paditësit, meqenëse në shkresat e lëndës mungon kjo ankese atëherë sipas mendimit tim përgjegjësia kryesore bie mbi instaluesin e energjisë elektrike në atë punëtori. Përgjegjësia krye këput është e instaluesit të rrymës elektrike por shkaktare është tensioni i dobët ose i ulët i cili është përgjegjësi e KEDS-it. Duke qene se instaluesi nuk e ka realizuar profesionalisht mbrojtjen nga mbi tensioni për realizimin e punës me tension të ulët mes dy fazave, i njëjti e ka realizuar punën por gjatë natës kur tensioni ka qene i lartë ka ardhur deri tek shkaktimi i zjarrit. Lëshimet e të paditurës në rastin konkret janë: 1 Nuk ka bërë matje të tensionit në vend ngjarje të ora në vitin 2013 edhe pse i ka pasur mundësitë teknike, 2 Është dashur KEDS-i të bëjë matjet dhe fotografitë por nuk i ka bërë sepse mendoj se kjo nuk i ka konvencuar meqenëse tensioni ka qene i dobët”.

Me leximin e Ekspertizës së ndërtimitarisë e dt. 17.07.2024 e ekspertit Agim Dërguti nga Ferizaj, gjykata ka vërtetuar se: **KONSTATIMET DHE REKOMANDIMET** Me rastin e vizitës në terren më 02.07.2024 kemi vërejtur se në hapësirën ku dikur ishte objekti i cili është dëmtuar nga zjarri, tani më nuk ekziston. Në vend të tij është ndërtuar një objekt banimi me etazhitet “P+2” në të cilin jeton familja e z. A.A. Meqenëse tani objekti nuk ekziston si dhe gjësendet të cilat kanë qenë brenda në objektin e dëmtuar nga zjarri nuk janë, atëherë jemi detyruar që të listojmë të gjitha dëmet sipas deklaratës së z. A.A, të cilat janë : Është dëmtuar depoja e cila ka pasur dimensionet LxB = 15.0 x 5.0 m dhe lartësi H= 3.0m, Konstruksioni i objektit i ndërtuar me material drusor si dhe mbulesa (kulmi), që në tërësi kanë sipërfaqe S=200 m². Mveshja e jashtme e objektit me llamarinë si dhe mbulimi i kulmit me llamarinë, që në tërësi kanë sipërfaqe S=200 m², Mveshja e mureve të brendshme e cila ka qenë me shpërplakë prej druri me sipërfaqe S=120m², Dyshemeja e shtruar me shpërplakë prej druri me sipërfaqe S=75 m²., Mjetet e punës të cilat janë përdorë për prodhimin e mobiljeve si: një sharr elektrike (circular), një shpuese e mbajtësve lëvizëse të derës (bagllamave), një shpues me bateri (aku), një prerëse metali elektrike (brusalicë) dhe Materiale të tjera.

Meqenëse rasti ka ndodhur vite më parë, objekti dhe materialet e dëmtuara nuk janë në vendngjarje, të gjitha materialet e listuara më lart sipas deklaratës së pronarit të objektit do të mundohemi t'i argumentojmë përmes metodologjisë së përdorur më poshtë.

Metodologjia e përdorur Për vlerësimin e dëmeve janë shfrytëzuar normativat teknike të vlerësimit dhe projektimit sipas standardeve në fuqi, përvoja 20 vjecare në hartimin e projekteve, menaxhimin e projekteve, vlerësime të objekteve si dhe vlerësimi i cmimit të tregut bazuar edhe në oferta. Fillimisht për të argumentuar ekzistimin e objektit kemi analizuar ortofotot e vitit 2012 me ato të vitit 2018. Në foton nr. 1 vërehet se objekti ka ekzistuar në vitin 2012 në parcelën me nr. P-72217039-00197-2. Në foton nr. 2 është paraqitur objekti i banimit me etazhitet P+2 në vendin e të cilit dikur ka qenë objekti të cilin z. A.A e shfrytëzuar për prodhimin e mobiljeve. Foto nr.1 dhe foto nr.2 janë paraqitur në raport për të argumentuar pikat e lartëcekura 1,2,3 se në parcelën P-72217039-00197-2 ka ekzistuar objekti me sipërfaqe $S=200m^2$ dhe që ka qenë i mveshur dhe i mbuluar me llamarinë me sipërfaqe $S=200m^2$. Foto nr. 3 e paraqitur në raport argumenton se objekti nga pjesa e mbrendshme ka qenë e mveshur me shpërplaka prej druri, që është paraqitur në pikën nr.4 të deklaratës së z. A.A dhe ka sipërfaqe $S=120m^2$. Foto nr.4 e paraqitur në raport argumenton se dyshemeja e objektit ka qenë e mveshur me shpërplaka prej druri, që është paraqitur në pikën nr.5 të deklaratës së z. A.A dhe ka sipërfaqe $S=75m^2$. Në pikën nr. 6 të deklaratës së z. A.A janë paraqitur mjetet e punës të cilat janë djegur nga zjarri të cilat janë: një sharr elektrike (circular), një shpuese e mbajtësve lëvizëse të derës (bagllamave), një shpuese me bateri (aku), një prerëse metali elektrike (brusalicë). Për të argumentuar këtë kam intervistuar biznese të ndryshme të cilat merren me prodhimin e mobiljeve. Pyetja të cilën ju kam bërë ka qenë, cilat janë mjetet e punës të domosdoshme për të filluar veprimtarinë e prodhimit të mobiljeve? Të gjitha bizneset kanë dhënë pothuajse të njëjtën përgjigje, ku kanë përmendur mjetet e punës të cilat i ka paraqitur edhe z. A.A si dhe mjete të tjera të cilat janë të domosdoshme por që z. A.A nuk i kishte në punëtorinë e tij. Këto mjete të punës, sipas tyre janë elementare për fillimin e veprimtarisë për prodhimin e mobiljeve. Për të bërë vlerësimin e dëmeve të cilat janë shkaktuar nga zjarri me datën 28.05.2013, kemi analizuar të gjitha materialet me të cilat ka qenë i ndërtuar objekti, mjetet e punës të cilat kanë qenë brenda objektit dhe janë përmbledhë në një tabelë në formatin Excel e cila përfshin të gjitha pozicionet e nevojshme për të ndërtuar objektin e ngjashëm bashkë me mjetet e punës. Pas përgatitjes së paramasës së punëve, janë marr ofertat nga tri kompani të ndryshme ndërtimore të licensuara, për të caktuar cmimin e tregut për secilin pozicion. Cmimi i tregut është caktuar nga mesatarja e cmimeve të tri ofertave të kompanive ndërtimore, i cili është (10,310.00 euro + 7,072.40euro + 6,745.57

euro) /3 = 8,042.57 euro. Vlera e dëmit e shkaktuar në punëtorinë e z. A.A i cili jeton në rrugën “Enver Topalli” në Ferizaj është 8,042.57 euro.

Me leximin e Formës së aplikimit për kërkesa të rrjetit të datave 22.09.2021, 01.12.2021 dhe tri foto në fletë A4, gjykata ka vërtetuar se paditësi ka kërkuar ndërrimin e trafos apo të jetë tensioni në nivelin e duhur e jo 160-180 V për këtë posedojmë foto dhe video si dëshmi të tensionit të ulët që shumë vite, si dhe shihet një shtyllë e rrezuar dhe vërtetohet se paditësi ka kërkuar për shkak të dëmtimit të shtyllës ndërrimin – zëvendësimin e saj.

Paditësi në shqyrtimin gjyqësor të dt. 06.11.2024 është dëgjuar në cilësi të palës, në të cilin ka deklaruar se: “kam filluar punën si zdrukhtare, nuk me ka ecur biznesi kumedit se sa dhe në kohe e djegjes se depos unë isha në Itali, djega e depos ka ndodhur me datë 28.05.2013, si pasojë e kësaj është tensioni i dobët i rrymës, prej asaj kohe edhe sot kemi dëshmi se kemi probleme me tension të rrymës, ku nuk jam i vetëm por kemi edhe dëshmitare që nuk janë në mbiemër tim të lagjes ku kanë probleme të njëjta. E ka thirrur vëllau Dritoni policinë për rastin e djegjes së punëtorisë dhe kam informata se ka ardhur policia, zjarrfikësit në vendin e ngjarjes dhe kanë bërë shuarjen e zjarrit dhe kanë thënë se ekspertizën e metejshme e vazhdojnë organet e KEK-UT. KEK-u është dalur në vend të ngjarjes me datë 26.07.2013, por unë nuk kam qenë aty kam qenë në Itali dhe ka bërë vlerësimin e tyre sepse rryma është në mënyrë jo të rregullt. Por nuk është e cekur asnjëherë se çfarë trashësie të kabllove ka pasur të vendosur, për atë arsye janë edhe dëshmitarët sepse në shtëpitë e tyre në atë kohe ka pasur probleme në amvisëritë e tyre në formë të djegjeve, unë e kom vlerësu me vlerë 5000 euro që është cekur në padi si vlerë e përafërt pa vlerësuar punë dore asgjë dhe pa e vlerësuar kohën që kam mbetur keq prej asaj dite, sigurisht se lidhjen e energjisë elektrike në shtëpi dhe në punëtori nuk e kam bërë vetë sepse nuk kam qenë i profesionit të tillë ndërsa nuk më kujtohet emri i personit që ka kryer lidhjen e energjisë elektrike. Furnizimi ka qenë në mënyrë të rregullt pasi që lidhjen e ka bërë punëtori përgjegjës i asaj lëmie që e kam angazhuar unë. Lidhja ka qenë e rregullt, ora ka qenë e kompanisë së KEK-ut kështu që unë nuk kam qenë i përzier në këtë pjesë, kam qenë konsumator i KEK-ut. Nuk e kam regjistruar në kadastrë punëtorinë si dhe as biznesin nuk e kam pasur të regjistruar në ARBK. Nuk e kam parë të arsyeshme që të startoj me të gjitha obligimet si në rastin konkret të lihet ora e posaçme punëtorisë kështu që kam vazhduar me kabllo në mënyrë të rregullt prej orës së shtëpisë time në punëtorinë time kështu që nuk është e ndaluar të zgjatesh një kabllo një shërbim që të duhet. Me sa më kujtohet shifra e DFE-së ka qenë shifër e konsumatorit familjar”.

Gjykata duke vepruar në kuptim të nenit 362.1 të LPK, e ka ftuar ekspertin e elektros I.C në shqyrtim gjyqësor dhe ekspertin e ndërtimtarisë A.D për të dhënë sqarime shtesë, ku palët e kanë pasur mundësinë të bëjnë pyetje dhe të kërkojnë sqarime shtesë nga ana e ekspertit.

Baza ligjore

Neni 136.2. i LMD nr. 04/L-077 Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedhë rreziku i shtuar i dëmit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga faji.

Neni 154 i LMD “Prezumimi i kauzalitetit” Dëmi i shkaktuar lidhur me sendin e rrezikshëm, përkatësisht me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ky send, përkatësisht nga kjo veprimtari, përveç nëse provohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit.

Neni 155 i LMD “Kush përgjigjet për dëmin” Për dëmin nga sendi i rrezikshëm përgjigjet zotëruesi i saj, kurse për dëmin nga veprimtaria e rrezikshme përgjigjet personi që merret me të.

Neni 169 i LMD “Rivendosja e gjendjes së mëparshme dhe shpërblimi në të holla” 1. Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi. 2. Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla. 3. Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t'ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit. 4. Gjykata do t'i gjykojë të dëmtuarit shpërblimin në të holla kur ai këtë e kërkon, me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret e arsyetojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme.

Neni 176 “Përgjegjësia e ndarë” 1. I dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose të jetë më i madh se sa përndryshe do të ishte, ka të drejtë vetëm në shpërblimin përpjesëtimisht të pakësuar. 2. Për paragrafin paraprak vihen përshtatshmërisht në zbatim dispozitat për përgjegjësinë për përfaqësuesin ligjor dhe ndihmësin. 3. Kur është e pamundur të vërtetohet se cila pjesë e dëmit rezulton nga veprimi i të dëmtuarit, gjykata do të gjykojë shpërblimin duke pasur parasysh rrethanat e rastit. 4. Dëmtuesi dhe i dëmtuari mbajnë barrën e provës për kontributin e atij tjetrit në shkaktimin dhe për kauzalitetin e këtij kontributi për dëmin dhe lartësinë e tij.

Pika 5. e Kodit të Matjes së Energjisë Elektrike të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së KEDS, Emërtimet e shfrytëzuara në kodin e matjes së OSSh-së: “5.1.1. Terminologjia e përdorur është sipas ligjeve në fuqi, terminologjisë së përdorur në Kodin e Shpërndarjes dhe me të gjitha procedurat e OSSh-së”, thuhet se: Luhatjet e Tensionit-Një seri ndryshimesh të shpejta tensionit, që mund të jenë të rregullta ose të çrregullta dhe thuhet se: “Tensioni i Ulët-Tensioni në nivelin nën 1 kV.”.

Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të LPK, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, si dhe duke vendosur në bazë të udhëzimeve të dhëna në aktvendimin Ac.nr.737/18 të datës 05.04.2022 të Gjykatës së Apelit e Kosovës, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Nuk është kontestues fakti se më dt. 28.05.2013 rreth orës 22:25 minuta, paditësit i është djegur punëtorja e tij në të cilin ai e zhvillonte aktivitetin biznesor përkatësisht mobilerinë e tij dhe të gjitha mjetet që gjendeshin në atë punëtori, si pasojë e çrregullimeve të energjisë elektrike.

Kontestues ndërmjet palëve ndërgjyqëse është fakti se kush është përgjegjës për dëmin e shkaktuar material, ku palët kishin pikëpamje diametralisht të kundërta nga njëra - tjetra.

Gjykata sa i përket legjitimitetit aktiv të paditësit në këtë procedurë, konstaton se paditësi bazuar në provat e administruara përgjatë kësaj procedurë ka legjitimitet aktiv, për arsye se, objekti i cili është djegur në rr. Enver Topalli në Ferizaj, me datë 28.05.2013, në atë kohë ka qenë në posedim të paditësit, fakt të cilin gjykata e vërtetoi nga ekspertiza e elektros dhe dëgjimi i ekspertit të elektros në shqyrtim gjyqësor ku ka thënë se “Paditësi e ka pasur vetëm një njehsor prej te cilit është furnizuar me energji elektrike, me shifrën e njehsorit 132442, numri i njehsorit 17694770, prej këtij njehsori e ka zgjatur kabllon në punëtorin e tij- mobilerine”.

E paditura është thirrur në atë se mungon certifikata e biznesit e lëshuar nga ARBK, ndaj këtij pretendimi të palës së paditur, pala paditëse nuk ka dorëzuar ndonjë certifikatë të biznesit që e vërteton të kundërtën, se ai e kishte pasur biznesin e regjistruar, por pavarësisht kësaj sipas vlerësimit të gjykatës, objekti i kontestit në këtë çështje juridiko-civile është kompensimi i dëmit material, si pasojë e çrregullimeve elektrike në objektin e paditësit, në të cilin ai ishte de facto duke e ushtruar veprimtarinë e punëtorisë, por që mospasja e certifikatës së biznesit, si kusht

puro administrativ, nuk është pengesë në realizimin e dëmshpërblimit, sepse shpërblimi i dëmit është kërkuar në emër të paditësit A.A, në kapacitetin personal, e jo në emrin e ndonjë biznesi të caktuar, cilido qoftë ai.

Pretendimi i të paditurës gjatë procedurës, është tërësisht i pabazuar, pasi që në rastin konkret pala paditëse e ka legjitimuar veten përmes provave në shkresat e lëndës, duke provuar se të njëjtit i është shkaktuar dëmi në shtëpinë e cila ka qenë në posedim të tij, pavarësisht faktit se nuk ka ofruar dokumentacion pronësor, po ashtu fakti se shtëpia ka qenë në mënyrë të rregullt e kyçur në sistemin energjetik të paditurës, paditësin e legjitimon në këtë procedurë në raport me të paditurën.

Ndërsa fakti se është apo nuk është pronar i objektit të djegur, në këtë procedurë është jo relevant në kuptim të dokumentacionit pronësor, dhe nuk e determinon çështjen e legjitimitetit të palës në procedurë, pasi në procedurën për kompensimin e dëmit, është i mjaftueshëm fakti se dëmi është shkaktuar dhe ky dëm i është shkaktuar paditësit dhe pasurisë së tij, siç është në rastin konkret.

Pretendimi se paditësi nuk i plotëson kushtet për të qenë pronarë sipas nenit 36, të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore nr.03/L-154, dt. 04.08.2009, është i pabazuar pasi gjykata në këtë procedurë nuk ka tagër të vlerësoj nëse janë plotësuar kushtet për fitimin e të drejtës së pronësisë, por kufizohet vetëm nëse dëmi e ka goditur pasurinë e paditësit, siç është në rastin konkret. (Shih lidhur me këtë Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Rev.nr.152/2021, datë 17.03.2022)

Ekspertizën e elektros dhe ekspertizën e ndërtimtarisë, e paditura përveç që e kanë kundërshtuar në kuptimin formal, nuk kanë parashtruar asnjë provë, apo fakt që do të vërtetonte të kundërtën e përfundimeve të arritura në këto ekspertiza.

Po ashtu e paditura nuk ka parashtruar propozim për nxjerrjen e ekspertizës së re, as nga lëmia e elektros apo ndërtimtarisë, ndonëse është pyetur nga gjykata nëse kanë propozim për nxjerrje të provave të reja, si një nga mënyrat për kundërshtimin e përfundimeve të arritura në ekspertizën e ekspertit të elektros I.C dhe ekspertit të ndërtimtarisë A.D.

Në këto raste gjykata është e detyruar të vendos në bazë të provave të administruara, ndërsa bazuar në nenin 319.1, lidhur me nenin 322.1 të LPK-së, ku parashihet që secila palë ndërgjyqëse ka për detyrë të provoj faktet mbi të cilat i bazon pretendimet e veta, ku dhe barra e provës për

të vërtetuar të kundërtën e përfundimeve të arritura si në ekspertizat e lartcekura i takon të paditurës, andaj deri sa nuk ka provuar themelësinë e pretendimeve të tyre, gjykata me të drejtë nuk i ka marrë parasysh, andaj dhe Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke i refuzuar pretendimet e të paditurës, pasi kërkesëpadia e paditësit në bazë të provave të administruara në këtë çështje është pjesërisht e bazuar.

Gjykata i ka vlerësuar të gjitha pretendimet si për përgjegjësinë e kontestuar, ashtu edhe për lartësinë e dëmit të gjykuar por ka gjetur se e paditura nuk ka arrit t'i provojë pretendimet e saj, ndërsa pala paditëse me provat e administruara i ka provuar të gjitha faktet nga të cilat ka dal si e themeltë kërkesëpadia.

Andaj, gjykata në bazë të provave të administruara, dhe në kuptim të dispozitave nga neni 154, 173 dhe 174 të LMD-së, ka vendosur që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovojë pjesërisht si të bazuar, duke shtuar se nga provat e administruara, u vërtetua se shkaktar i dëmit është energjia elektrike e cila sipas vetive të veta përfaqëson send të rrezikshëm në posedim të paditurës, e po ashtu veprimtaria me të cilën merret e paditura përfaqëson veprimtari të rrezikshme, e për dëmin e shkaktuar nga sendi i rrezikshëm dhe veprimtaria e rrezikshme përgjigjet e paditura në bazë të dispozitave të lartcekura.

Në çdo rast kur gjykatës i mungon dijenia profesionale për konstatimin e ndonjë fakti apo rrethane ajo shfrytëzon mjetet provuese ligjore që janë të lejueshme, për çka bën marrjen e provës me ekspertizë përkatëse. Në këtë kuptim duke qenë se si rrethanë kontestuese është paraqit përgjegjësia objektive e të paditurës për të kompensuar dëmin e paditësit, gjykata në cilësinë e provës ka bërë nxjerrjen ekspertizës së elektroteknikës me të cilën ka konstatuar shkaku dhe rrjedhimisht edhe përgjegjësinë për kompensimin e dëmit.

Pasi që dëmi është shkaktuar si pasojë e shkaktarit dhe përgjegjësit kryesor teknik që është instaluesi i rrymës në atë punëtori, por këto gabime që i ka bërë mjeshtri janë si pasojë e tensionit të ulët elektrik e që për këtë duhet të marrë një pjesë të përgjegjësisë teknike edhe KEDS-i, kjo gjykatë vlerëson se e paditura i detyrohet paditësit, pra është përgjegjës civilisht para tij, për dëmet që janë shkaktuar më datë 28.05.2013. Kjo vërtetohet edhe nga mendimi i ekspertit të elektros, për çka e paditura i detyrohet paditësit mbi bazën e nenit 169 lidhur me nenet 154 dhe 155 të LMD-së.

Gjykata vlerëson se eksperti i elektros, në bazë të provave ekzistuese dhe njohurive profesionale, ka nxjerrë përfundimin lidhur me atë se si ka ardhur deri te shkaktimi i zjarrit.

Gjykata vlerëson se me provat e administruara në këtë çështje juridike kontestimore u vërtetua bazueshmëria e kërkesëpadiës. Provat të cilat u administruan nga ana e gjykatës sipas propozimit të palës paditëse, përfshirë ekspertizën nga lëmia e elektros e punuar nga eksperti I.C, të cilës gjykata ja fali besimin, sepse e njëjta ishte profesionale, ishte bazuar në të gjitha provat që gjinden në shkresat e lëndës, përfshirë: të gjithë materialin e përbërë në shkresat e lëndës si dhe bazuar në mundësinë që secila palë të paraqesë provat e saj gjatë ekspertimit.

Gjykata vlerëson se tek rastet e shkaktimit të dëmit duhet të plotësohen disa kushte siç janë: a) ekzistenca e dëmit, b) ekzistenca e paligjshmërisë së veprimit ose të mosveprimit, c) ekzistenca e fajit, dhe d) ekzistenca e lidhjes shkakësore midis veprimit ose mosveprimit dhe dëmit të ardhur.

Lidhja shkakore paraqet raportin e ndërsjellët, ndërmjet veprimit të dëmshëm dhe dëmit, në të cilin veprimi i dëmshëm paraqitet si shkak, kurse dëmi si pasojë e tij. Pra lidhja kauzale është një ndër kushtet e përgjithshme për lindjen e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, që ekziston midis veprimit ose mosveprimit të dëmshëm dhe dëmit të shkaktuar. Çdo ngjarje që është kusht për dëmin, d.m.th., pa të cilin ky dëm nuk do të kishte ndodhur, konsiderohet si një shkak dhe e detyron të paditurën të shpërblej dëmin. Së këndejmi lidhja kauzale duhet të jetë e atillë që duhet të dëshmojë për ngjarjen e cila sigurt është shkaktuar si pasojë e veprimit apo mosveprimit të të paditurës.

Përfundimisht, në këtë proces kontestimor, pala paditëse arriti të argumentojë se me veprimet apo mosveprimet e të paditurës, është shkaktuar pasoja. Si përfundim gjykata thekson se paditësi ka paraqitur prova relevante për të argumentuar pretendimin si në kërkesëpadi, përmes së cilës ka kërkuar kompensimin e dëmit të shkaktuar nga zjarri.

Neni 7, par. 1 i LPK ka përcaktuar se: “Palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”, andaj gjykata është e lidhur vetëm me propozimet dhe provat të cilat i propozojnë palët ndërgjyqëse, siç edhe është vepruar në rastin kontestues.

Vlen të potencohet se në këtë çështje juridiko-civile procedura e sigurimit gjyqësor të provës me vend shikimin në vendngjarje në prezencë të palëve ndërgjyqëse nuk është bërë për të siguruar të dhëna relevante të besushme për të përcaktuar gjendjen reale pas zjarrit dhe në bazë të saj edhe shkaktarin e zjarrit.

Ekspertizën e lartpërmendur e kryer nga eksperti I.C nga Ferizaj, gjykata e mori në tërësi të bazuar dhe ia dha besimin e plotë, ngase kjo ekspertizë përmban elementet e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale dhe arsye të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoi si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Mbi bazën e kësaj gjendje faktike gjykata vlerësoi se paditësi ka arritur të ofrojë të dhëna të mjaftueshme që do të bënin përgjegjëse të paditurën lidhur me dëmin e shkaktuar për zjarrin i cili ka ndodhur në rr. Enver Topalli në Ferizaj, rreth orës 22:25 më dt. 28.05.2013.

Prandaj bazuar në këtë ekspertizë gjykata vie te përfundimi i drejtë dhe i ligjshëm që përgjegjësia e të paditurës mbështetet në lëshimet e saj të përcaktuara në ekspertizë si dhe të sqaruara në shqyrtim gjyqësor nga ana e ekspertit të elektros, në shkallën prej 30 %, në raport me masën, natyrën, vëllimin dhe numrin e lëshimeve nga ana e saj. Ndërsa përgjegjësia e paditësit vlerësohet në shkallën prej 70 % si përgjegjës primar dhe shkaktar i incidentit të energjisë elektrike, në raport me lëshimet e tij dhe natyrën e sjelljeve të tija. Përshkallëzimi në përqindje i përgjegjësisë së palëve ndërgjyqëse është bërë konform nenit 176 të LMD.

Vendimi mbi kërkesat aksesore

Lidhur me kamatën, është vendosur duke e detyruar të paditurën që shumat e gjykuara nga pika II. e dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ia paguajë paditësit së bashku me kamatën ligjore prej 8% në vit, e cila për shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit material, do të llogaritet nga data e ushtrimit të padisë, datë 12.03.2014 (gjë që vërtetohet nga vula e pranimit në gjykatë), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit me dhunë. Një vendosje e tillë është mbështetur në dispozitën nga neni 382 të LMD-së, i cili ka qenë i aplikueshëm në momentin e shkakimit të dëmit, e cila parasheh që: "Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë". Gjykata me rastin e përcaktimit të periudhës kohore nga e cila fillon të rrjedhë kamata për format e dëmit material) iu referua Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr.265/2020, të dt.02.12.2020, konkretisht pjesës së tretë, pikave XIV të këtij Mendimi.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës, nga pika III. e dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e mbështeti në dispozitat nga nenet 452, paragrafi 2, 453, lidhur me nenin 463, paragrafi 1 të LPK, duke e obliguar të paditurën që paditësit, t'ia kompensojë shumën e shpenzimeve të

nevojshme dhe të domosdoshme të krijuara deri në këtë fazë të procedurës sipas kërkesës së specifikuar në vlerë të përgjithshme prej 382.56, duke u bazuar në përgjegjësinë 30% të paditurës. Përcaktimi i lartësisë është bërë duke e llogaritur lartësinë e shumës së shpenzimeve të paraparë me Tarifën e OAK për veprimin e ndërmarrë, duke e zbritur me përqindjen e përgjegjësisë së paditurës në shkallën prej 30% në shkaktimin e dëmit. Shpenzimet njihen për: taksë për padi 60,00€, për përpilimin e padisë nga avokati 104,00€, për përfaqësim në 6 seanca gjyqësore të datave 14.11.2017, 19.07.2022, 06.12.2023, 18.03.2024, 19.06.2024, 06.11.2024. Sa i përket shumës së shpenzimeve të aprovuara, gjykata ju referua Tarifës së Odës së Avokatëve (numrave tarifor 6 dhe 7) si dhe Udhëzimit Administrativ të KGJK lidhur me Unifikimin e Taksave Gjyqësore të dt. 22.03.2017. Lidhur me shpenzimet e aprovuara gjykata i është referuar nenit 453 të LPK, i cili parasheh që: “453.1 Me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t’i shpërblehen palës, gjykata do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendos gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat. 453.2 Po që se është parashikuar tarifa për shpërblimin e avokatëve, apo për shpenzimet tjera, atëherë këto shpenzime do të matën sipas tarifës së tillë.”.

Gjykata ka bërë vlerësimin edhe të provave të tjera të administruara dhe të përmendura më lartë, por vlerësoi se të njëjtat janë pa ndikim në zgjidhjen meritore të kësaj çështje juridike.

Andaj, gjykata nga të lartë cekurat vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform 143 të LPK.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Datë 26.12.2024

Gjyqtari

Armend Ahmeti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtën e ankesës në Gjykatën e Apelit e Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 dite nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.